



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare
www.legjislacionishqiptar.gov.al

Nr.3

2006

30 janar

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Vendim i Kuvendit nr.16, datë 16.1.2006	Për zgjatjen e afatit të veprimtarisë së Komisionit Hetimor për hetimin e zbatimit të legjislacionit në përgatitjen dhe zhvillimin e procesit zgjedhor të datës 3 korrik 2005.....	59
Vendim i Kuvendit nr.17, datë 19.1.2006	Për ngritjen e Komisionit të Posaçëm Parlamentar për Reformën Zgjedhore.....	59
Dekret nr.4756 datë 19.1.2006	Për lejim lënie të shtetësisë shqiptare.....	60
Vendim i AMS nr.2, datë 23.1.2006	Për miratimin e rregullores nr.1, datë 23.1.2006 “Për rregullat dhe kufijtë e investimit të kapitalit të shoqërive të sigurimit”.....	61
Vendim i AMS nr.3, datë 23.1.2006	Për miratimin e aksionarëve me pjesëmarrje influencuese në shoqërinë e sigurimit “Dukagjini” Al sh.a.....	63
Vendim i KKRT nr.407, datë 23.1.2006	Për rinovimin e licencës së subjektit televiziv vendor “TV 4+”.....	63
Vendim i KKRT nr.408, datë 23.1.2006	Për rinovimin e licencës së subjektit televiziv vendor “TV Johaniter”.....	64
Vendim i KKRT nr.409, datë 23.1.2006	Për rinovimin e licencës së subjektit televiziv vendor “TV Kombi”.....	64
Vendim i KKRT nr.410, datë 23.1.2006	Për rinovimin e licencës së subjektit televiziv vendor “TV Amantia”.....	65

Vendim i KKRT nr.411, datë 23.1.2006	Për rinovimin e licencës së subjektit radiofonik “Rock”	65
Vendim i KKRT nr.412, datë 23.1.2006	Për rinovimin e licencës së subjektit televiziv vendor “TV AVN”	66

VENDIM
Nr.16, datë 16.1.2006

**PËR ZGJATJEN E AFATIT TË VEPRIMTARISË SË KOMISIONIT HETIMOR
PËR HETIMIN E ZBATIMIT TË LEGJISLACIONIT NË PËRGATITJEN DHE
ZHVILLIMIN E PROCESIT ZGJEDHOR TË DATËS 3 KORRIK 2005**

Në mbështetje të neneve 7 dhe 8 të ligjit nr.8891, datë 2.5.2002 "Për organizimin dhe funksionimin e komisioneve hetimore të Kuvendit", si dhe të nenit 25 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e vetë Komisionit Hetimor,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

I. Zgjatet edhe 20 ditë afati i veprimtarisë së Komisionit Hetimor të Kuvendit për hetimin e zbatimit të legjislacionit në përgatitjen dhe zhvillimin e procesit zgjedhor të datës 3 korrik 2005.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R E
Jozefina Topalli (Çoba)

VENDIM
Nr.17, datë 19.1.2006

**PËR NGRITJEN E KOMISIONIT TË POSAÇËM PARLAMENTAR
PËR REFORMËN ZGJEDHORE**

Në mbështetje të nenit 77 pika 1 të Kushtetutës, si dhe të nenit 24 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e një grupi deputetësh,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Ngrihet Komisioni i Posaçëm Parlamentar për Reformën Zgjedhore.

II. Komisioni ka për detyrë përgatitjen e amendamenteve të nevojshme të kuadrit ligjor për arritjen e standardeve në zgjedhjet, mbështetur në rekomandimet e paraqitura në raportin e Komisionit Vëzhgues të OSBE/ODIHR-it për zgjedhjet parlamentare 2005.

III. Komisioni përbëhet nga 22 anëtarë, 12 (6+6) nga dy partitë e mëdha dhe 1 anëtar nga secila parti parlamentare.

IV. Komisioni i Posaçëm Parlamentar drejtohet nga dy bashkëkryetarë, një nga Partia Demokratike dhe një nga Partia Socialiste.

V. Pranë Komisionit të Posaçëm Parlamentar ngrihet grupi i ekspertëve teknikë. Përbërja dhe mënyra e funksionimit të tij përcaktohen me vendim të Komisionit të Posaçëm Parlamentar.

VI. Vendimet në Komision merren me shumicën e votave (12 vota), kur pro tyre kanë votuar në unanimitet përfaqësuesit e dy partive të mëdha (6+6).

VII. Komisioni e ushtron veprimtarinë për një afat prej tre muajsh nga data e vendimit.

VIII. Ngarkohet Kryetarja e Kuvendit për krijimin e kushteve të punës dhe mbështetjen logjistike të veprimtarisë së Komisionit.

IX. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R E
Jozefina Topalli (Çoba)

DEKRET
Nr.4756, datë 19.1.2006

PËR LEJIM LËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92 pika "c" të Kushtetutës, të neneve 15, 19 dhe 20 të ligjit nr.8389, datë 5.8.1998 "Për shtetësinë shqiptare", bazuar edhe në propozimin e Ministrit të Rendit Publik,

DEKRETOJ:

Neni 1

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare me kërkesë të tyre personave të mëposhtëm:

- | | |
|------------------------------------|---|
| 1. Ardita Luan Koliqi (Karkini) | 36. Endri Hektor Veizaj |
| 2. Andia Astrit Koliqi | 37. Majlinda Sitki Veizaj (Kallogjeri) |
| 3. Jenny Astrit Koliqi | 38. Mylazim Mersin Sopaj |
| 4. Eglantina Agim Rexha (Kurshumi) | 39. Mersin Mylazim Sopaj |
| 5. Era Azem Rexha | 40. Natasha Fejzo Sopaj (Mixha) |
| 6. Blerta Azem Rexha | 41. Eni Mylazim Sopaj |
| 7. Thëllënxë Novruz Osmani | 42. Hadixhe Sehit Lloshaj |
| 8. Miklim Osmën Jonuzaj | 43. Mariza Shkëlqim Jaçe |
| 9. Ejvis Gjergji Tominaj (Marko) | 44. Majlinda Mustafa Gaxha (Kuqi) |
| 10. Sokol Fatbardh Tominaj | 45. Koleta Xhovalin Ejlli |
| 11. Bato Fatbardh Tominaj | 46. Kristi Xhovalin Ejlli |
| 12. Piero Valentin Bytyçi | 47. Luljeta Sami Zeqja |
| 13. Pëllumb Kujtim Mieth (Sadiku) | 48. Eduart Fejzi Povata |
| 14. Skënder Qamil Metani | 49. Llambrinije Jorgji Povata (Doçi) |
| 15. Meti Ismail Hushi | 50. Flavio Eduart Povata |
| 16. Miranda Nevruz Hushi (Metushi) | 51. Gertruda Eduart Povata |
| 17. Armela Meti Hushi | 52. Elvis Edmond Kusi |
| 18. Maris Meti Hushi | 53. Pirro Piro Gjeçi |
| 19. Stela Niko Manushi | 54. Shkelqim Vesel Salianj |
| 20. Alma Ali Tufa (Gjini) | 55. Fatmir Brahim Gjyriqi |
| 21. Greta Haxhi Qello | 56. Besnik Rushit Murataj |
| 22. Jonela Flamur Hoxha (Hysa) | 57. Albert Mihal Puqja |
| 23. Matthias Agron Hoxha | 58. Mario Albert Puqja |
| 24. Jessica Agron Hoxha | 59. Lorena Albert Puqja |
| 25. Suadi Taip Estrefi | 60. Aida Kristaq Puqja (Simaku) |
| 26. Albert Ahmet Axhenti | 61. Pranvera Tahsim Biehler (Mehmeti) |
| 27. Dominic Metin Albert Axhenti | 62. Joana Albert Mehmeti |
| 28. Zhana Sezai Brzoska (Sala) | 63. Kastriot Fat Broca |
| 29. Amber Sophie Michael Brzoska | 64. Aida Bektash Shuku |
| 30. Gëzim Ahmet Goga | 65. Pranvera Novrus Steidinger (Avdiaj) |
| 31. Drita Ndue Ndoja-Herd (Ndoja) | 66. Irma Ramazan Gashi (Vidhi) |
| 32. Rozana Françesk Ndoja | 67. Marsilda Bensik Isufi |
| 33. Elsa Shaban Fey (Dema) | 68. Endrit Bashkim Arkaxhiu |
| 34. Hektor Xhevat Veizaj | 69. Juard Bashkim Arkaxhiu |
| 35. Held Hektor Veizaj | 70. Flavia Arben Kalem |

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Alfred Moisiu

VENDIM
Nr.2, datë 23.1.2006

**PËR MIRATIMIN E RREGULLORES “PËR RREGULLAT DHE KUFIJTË E INVESTIMIT
TË KAPITALIT TË SHOQËRIVE TË SIGURIMIT”**

Në mbështetje të shkronjës “k” të pikës 2 të nenit 14 të ligjit nr.9268, datë 29.7.2004 “Për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit Mbikëqyrës të Sigurimeve”, nenit 58 dhe pikës 2 të nenit 95 e vijues të ligjit nr.9267, datë 29.7.2004 “Për veprimtarinë e sigurimit, risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime”, Këshilli i Autoritetit Mbikëqyrës të Sigurimeve

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullores “Për kufijtë e investimit të kapitalit të shoqërive të sigurimit”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.
 2. Rregullorja hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.
 3. Rregullorja t’u dërgohet për zbatim shoqërive të sigurimit.
- Ky vendim hyn në fuqi më 23.1.2006.

KRYETARI I KËSHILLIT
TË AUTORITETIT MBIKËQYRËS TË SIGURIMEVE
Asllan Shera

RREGULLORE
Nr.1, datë 23.1.2006

PËR KUFIJTË E INVESTIMIT TË KAPITALIT TË SHOQËRIVE TË SIGURIMIT

Në mbështetje të pikës 2 të nenit 95 dhe 58 të ligjit nr.9267, datë 29.7.2004 “Për veprimtarinë e sigurimit, risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime”, nenit 14 të ligjit nr.9268, datë 29.7.2004 “Për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit Mbikëqyrës të Sigurimeve”, Këshilli i Autoritetit Mbikëqyrës të Sigurimeve nxjerr këtë rregullore me përmbajtje si më poshtë:

Neni 1

Kjo rregullore përcakton kufijtë e investimit të kapitalit të shoqërive të sigurimit.

Për efekt të zbatimit të kësaj rregulloreje, termat e përdorur në të kanë të njëjtin kuptim si ata të shprehur në nenin 3 të ligjit nr.9267, datë 29.7.2004 “Për veprimtarinë e sigurimit, risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime” i shprehur si “Ligji” në këtë rregullore.

Neni 2

Qëllimi i kësaj rregulloreje është vendosja e ekuilibrit për aktivitetin e investimit të kapitalit të shoqërive të sigurimit dhe të respektimit të detyrueshëm të disa raporteve mbikëqyrëse.

Neni 3

Objekti i vendosjes së këtyre raporteve mbikëqyrëse është që shoqëritë e sigurimit të mos ushtrojnë në mënyrë të pakufizuar investimin e kapitalit të tyre, në mënyrë që të mos përballen në mënyrë të pakontrolluar, me rreziqe të ndryshme.

Neni 4

Investimi i kapitalit të një shoqërie siguriimi bëhet në mënyrë të tillë që të sigurohet ruajtja e

vlerës, përfitueshmëria dhe likuiditeti.

Neni 5

1. Kapitali i shoqërisë së sigurimit përbëhet nga kapitali themeltar dhe kapitali shtesë.
2. Kapitali i lejuar për t'u investuar nga shoqëritë e sigurimit është ajo pjesë e kapitalit, e cila kalon kufirin minimal të fondit të garancisë, të llogaritur sipas nenit 98 të ligjit nr.9267.

Neni 6

1. Drejtimit e investimit të kapitalit të shoqërive të sigurimit janë si më poshtë:
 - a) pasuri të paluajtshme (toka dhe ndërtesa);
 - b) investime financiare (letra me vlerë të qeverisë dhe të borxhit publik, letra borxhi, mjete të tjera të tregjeve të parasë dhe të kapitalit).

Neni 7

1. Shoqëritë e sigurimit investojnë kapitalin e tyre brenda territorit të Republikës së Shqipërisë.
2. Pavarësisht nga pika 1 e këtij neni, shoqëritë mund të investojnë jo më shumë se 10% të kapitalit të tyre në tregjet ndërkombëtare jashtë Shqipërisë vetëm në letra me vlerë të garantuara të qeverive të vendeve të Bashkimit Europian dhe të Amerikës së Veriut, pasi kanë marrë më parë miratim nga Autoriteti Mbikëqyrës i Sigurimeve.

Neni 8

1. Kapitali i shoqërisë së sigurimit mund të investohet deri në 5% (për qind) në hua të garantuara, me kusht që investimet individuale për hua të kësaj natyre të shoqërive të sigurimit nuk duhet të kalojnë më shumë se 1% (për qind) të vlerës së kapitalit të shoqërisë së sigurimit dhe duhet të shlyhen brenda një periudhe njëvjeçare.
2. Investimet financiare të shoqërisë së sigurimit në një bankë, nuk mund të kalojnë 25% (për qind) të kapitalit të shoqërisë së sigurimit.
3. Investimet financiare të shoqërisë së sigurimit në një person juridik jobankar (institucione financiare jobankare), nuk lejohet të tejkalojnë 10% (për qind) të kapitalit të shoqërisë së sigurimit.

Neni 9

Në rast të mospërmbushjes nga shoqëritë e sigurimit të detyrimeve të kësaj rregulloreje, Autoriteti Mbikëqyrës i Sigurimeve merr masa administrative të parashikuara në nenin 164 e vijues të ligjit nr.9267, datë 29.7.2004.

Neni 10

Kjo rregullore hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I KËSHILLIT TË AUTORITETIT
MBIKËQYRËS TË SIGURIMEVE
Asllan Shera

VENDIM
Nr.3, datë 23.1.2006

**PËR MIRATIMIN E AKSIONARËVE ME PJESEMARRJE INFLUENCUESE NË
SHOQËRINË E SIGURIMIT “DUKAGJINI AL” SHA**

Në mbështetje të pikës 2 të nenit 57 të ligjit nr.9267, datë 29.7.2004 “Për veprimtarinë e

sigurimeve, risigurimeve dhe ndërmjetësimin në sigurime dhe risigurime” dhe shkronjës “f” të nenit 6 dhe të shkronjës “k” të pikës 2 të nenit 14 të ligjit nr.9268, datë 20.7.2004 “Për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit Mbikëqyrës të Sigurimeve”, Këshilli i Autoritetit Mbikëqyrës të Sigurimeve

VENDOSI:

1. Të miratojë pjesëmarrjen influencuese të aksionarëve të shoqërisë së sigurimit “Dukagjini AL” sh.a. si më poshtë:

- a) Kadri Morinaj aksionar me pjesëmarrje prej 75% të aksioneve;
- b) Faik Bruci aksionar me pjesëmarrje prej 12% të aksioneve.

2. Autoriteti Mbikëqyrës i Sigurimeve rezervon të drejtën e revokimit të miratimit të pikës 1 të këtij vendimi në rast se më vonë do të rezultojë:

- a) është dhënë mbi bazën e informacionit të pasaktë ose të rremë;
- b) rrezikon veprimtarinë e shoqërisë së sigurimit sipas parashikimeve të kreut 6 të ligjit nr.9267, datë 29.7.2004.

Ky vendim hyn në fuqi më 23.1.2006.

**KRYETARI I KËSHILLIT TË AUTORITETIT
MBIKËQYRËS TË SIGURIMEVE
Asllan Shera**

**VENDIM
Nr.407, datë 23.1.2006**

PËR RINOVIMIN E LICENCËS SË SUBJEKTIT TELEVIZIV VENDOR “TV 4+”

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, “Rregullores mbi procedurat e rilicencimit të operatorëve privatë radio e televizivë”, Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë, të vendimit nr.400, datë 30.11.2005 të KKRT-së, si dhe kërkesës së subjektit të interesuar, Këshilli Kombëtar i Radios dhe i Televizionit

VENDOSI:

1. Të miratojë ndryshimet e të dhënave të paraqitura në kërkesën për marrjen e licencës nga ana e subjektit televiziv vendor privat “TV 4+”, si dhe pasqyrimin e këtyre ndryshimeve në licencën e subjektit.

2. Në mbarim të afatit të licencimit, sipas licencës nr.018/TVL, të rinovojë për një afat të ri 5-vjeçar në fushën e transmetimeve televizive tokësore analogjike, subjektin televiziv “TV 4+”.

3. Kushtet e licencës, sipas pikës 2 të këtij vendimi, mbeten të pandryshuara.

4. Ky vendim hyn në fuqi në datën 8.11.2005 dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI
Halil Lalaj**

**VENDIM
Nr.408, datë 23.1.2006**

**PËR RINOVIMIN E LICENCËS SË SUBJEKTIT TELEVIZIV VENDOR
“TV JOHANITER”**

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, “Rregullores mbi procedurat e rilicencimit të operatorëve privatë radio e televizivë”, Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë, të vendimit nr.401, datë 30.11.2005 të KKRT-së, si dhe kërkesës së subjektit të interesuar, Këshilli

VENDOSI:

1. Të miratojë ndryshimet e të dhënave të paraqitura në kërkesën për marrjen e licencës nga ana e subjektit televiziv vendor privat “TV Johaniter”, si dhe pasqyrimin e këtyre ndryshimeve në licencën e subjektit.
2. Në mbarim të afatit të licencimit, sipas licencës nr.007/TVL, të rinovojë për një afat të ri 5-vjeçar në fushën e transmetimeve televizive tokësore analogjike, subjektin televiziv “TV Johaniter”.
3. Kushtet e licencës, sipas pikës 2 të këtij vendimi, mbeten të pandryshuara.
4. Ky vendim hyn në fuqi në datën 8.11.2005 dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Halil Lalaj

VENDIM
Nr.409, datë 23.1.2006

PËR RINOVIMIN E LICENCËS SË SUBJEKTIT TELEVIZIV VENDOR “TV KOMBI”

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, “Rregullores mbi procedurat e rilicencimit të operatorëve privatë radio e televizivë”, Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë, të vendimit nr.403, datë 30.11.2005 të KKRT-së, si dhe kërkesës së subjektit të interesuar, Këshilli Kombëtar i Radios dhe i Televizionit

VENDOSI:

1. Të miratojë ndryshimet e të dhënave të paraqitura në kërkesën për marrjen e licencës nga ana e subjektit televiziv vendor privat “TV Kombi”, si dhe pasqyrimin e këtyre ndryshimeve në licencën e subjektit.
2. Në mbarim të afatit të licencimit, sipas licencës nr.016/TVL, të rinovojë për një afat të ri 5-vjeçar në fushën e transmetimeve televizive tokësore analogjike, subjektin televiziv “TV Kombi”.
3. Kushtet e licencës, sipas pikës 2 të këtij vendimi, mbeten të pandryshuara.
4. Ky vendim hyn në fuqi në datën 8.11.2005 dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Halil Lalaj

VENDIM
Nr.410, datë 23.1.2006

PËR RINOVIMIN E LICENCËS SË SUBJEKTIT TELEVIZIV VENDOR “TV AMANTIA”

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, “Rregullores mbi procedurat e rilicencimit të operatorëve privatë radio e televizivë”, Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë, të vendimit nr.402, datë 30.11.2005 të KKRT-së, si dhe kërkesës së subjektit të interesuar, Këshilli Kombëtar i Radios dhe i Televizionit

VENDOSI:

1. Të miratojë ndryshimet e të dhënave të paraqitura në kërkesën për marrjen e licencës nga

ana e subjektit televiziv vendor privat "TV Amantia", si dhe pasqyrimin e këtyre ndryshimeve në licencën e subjektit.

2. Në mbarim të afatit të licencimit, sipas licencës nr.006/TVL, të rinovojë për një afat të ri 5-vjeçar në fushën e transmetimeve televizive tokësore analogjike, subjektin televiziv "TV Amantia".

3. Kushtet e licencës, sipas pikës 2 të këtij vendimi, mbeten të pandryshuara.

4. Ky vendim hyn në fuqi në datën 8.11.2005 dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Halil Lalaj

VENDIM

Nr.411, datë 23.1.2006

PËR RINOVOMIN E LICENCËS SË SUBJEKTIT RADIOFONIK "ROCK"

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 "Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, "Rregullores mbi procedurat e rilicencimit të operatorëve privatë radio e televizivë", Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë, të vendimit nr.399, datë 30.11.2005 të KKRT-së, si dhe kërkesës së subjektit të interesuar, Këshilli Kombëtar i Radios dhe i Televizionit

VENDOSI:

1. Në mbarim të afatit të licencimit, sipas licencës nr.040/FML, të rinovojë për një afat të ri 3-vjeçar në fushën e transmetimeve radiofonike tokësore me modulim në frekuencë, subjektin "Radio Rock" sh.p.k. për "Radio Rock".

2. Kushtet e licencës, sipas pikës 1 të këtij vendimi, mbeten të pandryshuara.

3. Ky vendim hyn në fuqi në datën 8.11.2005 dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Halil Lalaj

VENDIM

Nr.412, datë 23.1.2006

PËR RINOVIMIN E LICENCËS SË SUBJEKTIT TELEVIZIV VENDOR "TV AVN"

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 "Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, "Rregullores mbi procedurat e rilicencimit të operatorëve privatë radio e televizivë", Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë, të vendimit nr.398, datë 30.11.2005 të KKRT-së, si dhe kërkesës së subjektit të interesuar, Këshilli Kombëtar i Radios dhe i Televizionit

VENDOSI:

1. Në mbarim të afatit të licencimit, sipas licencës nr.012/TVL, të rinovojë për një afat të ri 5-vjeçar në fushën e transmetimeve televizive tokësore analogjike, subjektin "AVN+15" sh.p.k. për televizionin "TV AVN".

2. Kushtet e licencës, sipas pikës 1 të këtij vendimi, mbeten të pandryshuara.

3. Ky vendim hyn në fuqi në datën 8.11.2005 dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Halil Lalaj

Fletorja Zyrtare gjendet: duke u abonuar pranë njësive postare të qyteteve ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare; në adresën: Bulevardi Zhan d'Ark, prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot" Tel: 042 555 63; 267 468

Pranë **Qendrës së Publikimeve Zyrtare** mund të gjeni:

REGJISTRAT E NOTERISË SIPAS FORMATIT TË MIRATUAR NGA MINISTRIA E DREJTËSISË 2005

1. REGJISTRI I PËRGJITHSHËM I AKTEVE DHE I VEPRIMEVE NOTERIALE	1000
2. REGJISTRI I TESTAMENTEVE	500
3. REGJISTRI I DEPOZITIMIT TË PARAVE OSE VLERAVE TË TJERA	500
4. INDEKSI ALFABETIK	600

PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI

1. PËR PROKURIMIN PUBLIK.....	1500
2. PËR NËPUNËSIN CIVIL (Botim, 2005)	600
3. PËR SISTEMIN E DREJTËSISË (Vëllim I- rë).....	1500
4. PËR TAKSAT DHE TATIMET.....	1500
1. TREGUESI KRONOLOGJIK I LEGJISLACIONIT SHQIPTAR 1990-Korrik 2004 ...	1500
2. TREGUESI TEMATIK I LEGJISLACIONIT SHQIPTAR 1990-Korrik 2004.....	2000

BOTIME TË REJA

1. PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR SISTEMIN E DREJTËSISË (Vëllim i II-të)	1500
2. KODI DOGANOR.....	1000
3. KODI DETAR	1000

.....

Doli nga shtypi më 30.1.2006

Tirazhi: 4000 copë	Formati: 60x88/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2006

Çmimi 100 lekë